

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 02.11.2020

Për: "NEAL-86" sh.p.k me adresë: Vlorë, Sarandë, Lagjja Nr.4.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim – Punë.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-73266-09-28-2020.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim i kopshtit për fëmijë, Fshati Bajkaj, Bashkia Delvinë” me fond limit **1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë)** lekë pa TVSH, dhe kohëzgjatje 60 (gjashtëdhjetë) ditë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike 82, datë 05.10.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët () oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “NEAL-86” SH.P.K *me Nr.* NIPTI K04814851T

Vlera 1,237,340 (një milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzetë) Lekë pa TVSH.

2. “TEA-D” SH.P.K *me Nr.* NIPTI K32522629L

Vlera 891,477.5 (Tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë pesë) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “TEA-D” SH.P.K NIPTI K32522629L

Vlera 891,477.5 (Tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë pesë) Lekë pa TVSH.

Në zbatim të Nenit 56 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 66, pika 5, u krye verifikimi i ofertave nëse ato ishin anomalisht të ulta.

Oferta e shoqërisë “TEA-D” sh.p.k pas verifikimit u vlerësua anomalisht e ulët. Në zbatim të Nenit 56 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar operatorit ekonomik “TEA-D” sh.p.k, ju dërgua shkresa me lëndë “Kërkesë për shpjegime dhe paraqitje dokumentacioni” me Nr. 2736 Prot. datë 19.10.2020, të paraqiste me shkrim, brenda tre ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) Anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) Zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) Originalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- d) Zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Njoftimi u krye nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) në rubrikën “Kërkesë e re”, në adresën e e-mailit të operatorit ekonomik më datë 19.10.2020, si dhe ju dërguar zyrtarisht në rrugë shkresore.

Nga ana e operatorit ekonomik “TEA-D” sh.p.k nuk u paraqitën shpjegimet e kërkuara brenda afatit të kërkuar, çka bëri që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të refuzojë ofertën e këtij operatori ekonomik si ofertë anomalisht e ulët.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se "NEAL-86" sh.p.k me NIPT K04814851T, me adresë: Vlorë, Sarandë, Lagjja Nr.4, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 1,237,340 (një milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzetë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Zyrës së Protokollit, Bashkia Delvinë, Lagjja "Sinan Ballaci", Rruga "Nazif Hadëri", Delvinë, Sigurimin e Kontratës dhe dokumentacionin e ngarkuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit Elektronik (*originale ose kopje e noterizuar*) siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.10.2020.

Ankesa: ka ose jo (**JO**)

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Majlinda Qilimi